



BASHKIA
TIRANË

R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt.03.12.2021]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “PC STORE” shpk

Adresa: Tirane Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Infrastrukturë Tik”** me Nr REF-10435-11-04-2021 për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Buletini Nr. 161 datë 8 Nëntor 2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1 Operatori ekonomik ”PC STORE” shpk

NUIS L01606034A

Vlera e ofertës pa TVSH– 32.900.000 (tridhjetë e dy milion e nëntëqind e mijë) lekë.

2 Operatori ekonomik "SINTEZA CO" shpk NUIS: K11324003F

Vlera e ofertës pa tvsh = **33.320.000** (tridhjetë e tre milion e treqind e njëzet mijë) lekë

Nga pjesëmarrësit wshtë s'kualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

1 Operatori ekonomik "SINTEZA CO" shpk NUIS: K11324003F

Për arsyet e mëposhtme:

për "Prokurimin publik", dhe Kreut VII, neni 82, pika 2 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga kjo shoqëri, nga ku rezultoi si më poshtë:

I. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2. "Kriteret e veçanta të kualifikimit" të dokumenteve standarde të tenderit, përcakton se ofertuesi duhet te paraqesë:

"2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8".

Në nenin 26 të VKM, përcaktohet:

"1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla...."

Operatori ekonomik "Sinteza CO" Sh.p.k ka paraqitur formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, data e dorëzimit të së cilës është 06.10.2021, ndërkohë që procedura e prokurimit me objekt "Infrastrukturë TIK" dhe Nr. reference REF-10435-11-04-2021 është publikuar në APP në datën 05.11.2021.

Sa më sipër, data e deklaratës e cila përmban informacion mbi kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes të përcaktuara nga Autoriteti kontraktor, nuk përkon me periudhën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për të cilën operatori ekonomik ka marrë pjesë dhe operatori ekonomik, nuk ka plotësuar kriterin sipas shtojcës 8.

II. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2."Kriteret e veçanta të kualifikimit" të dokumenteve standarde të tenderit, përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Operatori ekonomik "SINTEZA CO" sh.p.k nuk ka paraqitur në spe sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3, duke mos përmbushur kështu kriterin 1/b të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit.

III. Pjesë e kritereve të vecanta të kualifikimit, është kërkesa sipas pikës “2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

“2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

Operatori ekonomik “SINTEZA CO” Sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.2.1.

IV. Pjesë e kritereve të vecanta të kualifikimit, është kërkesa sipas pikës “2.3 Kapaciteti teknik” referuar së cilës kërkohet:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”*

Operatori ekonomik “SINTEZA CO” Sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.3.1.

V. Pjesë e kritereve të vecanta të kualifikimit, është kërkesa sipas pikës “2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

a) ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

b) ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes”.

Operatori ekonomik “SINTEZA CO” Sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.3.2.

VI. Në kriteret e vecanta të kualifikimit, Autoriteti kontraktor ka kërkuar në pikën “2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose Autorizim Distributori për paisjet e ofruara nga zërat 1,2,3,4,5,8,9,10. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi”.

Operatori ekonomik “SINTEZA CO” Sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.3.3.

VII. Në kriteret e vecanta të kualifikimit, Autoriteti kontraktor ka kërkuar në pikën “2.3.4 Operatori ekonomik duhet që në ofertën teknike të paraqesë markën, modelin shoqëruar me katalogë ose broshura për mallrat që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të cdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Fleta ose fletët e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes dhe të softëare duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

Në ofertën teknike gjithashtu duhet të jepet informacion i detajuar me të gjithë numrat e pjesëve të të gjithë komponentëve dhe sasi të tyre të konfigurimit të propozuar sipas zërave të kërkuar në dokumentin e specifikimeve teknike (aty ku është kërkuar).”

Operatori ekonomik “SINTEZA CO” Sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.3.4 të dst.

VIII. Në kriteret e vecanta të kualifikimit, Autoriteti kontraktor ka kërkuar në pikën “2.3.5 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë në të cilën të deklarojë se mallrat objekt i procedurës do të instalohen dhe konfigurohen prej tij (për zërat ku është parashikuar F.V në

dokumentin e specifikimeve teknike) dhe që kanë një afat garancie sipas garancisë së përcaktuar në specifikimet teknike të zërave përkatës.”

Operatori ekonomik “SINTEZA CO” Sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.3.5.

IX. Në kriteret e vecanta të kualifikimit, Autoriteti kontraktor ka kërkuar në pikën “2.3.6 Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, cilësinë e punës gjatë instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve (F.V) si dhe për të garantuar suportin dhe garancinë përgjatë periudhës së parashikuar sipas specifikimeve teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- *1 (një) specialist të certifikuar për sistemin e menaxhimit të politikave të sigurisë dhe aksesit në rrjet ose ekuivalente.*
- *Të paktën 1(një) specialist të certifikuar në nivel min profesional, fusha Sëitching ose ekuivalent.*
- *1 (një) specialist të certifikuar në nivelin min profesional për Platformën Appliance Virtuale të ofertuar.*

Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Për të vërtetuar kriterin 2.3.6, operatori ekonomik duhet të paraqesë :

- *Certifikatat përkatëse për secilin nga specialistët e mësipërm;*
- *Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B”*

Operatori ekonomik “SINTEZA CO” Sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.3.6.

Sa më sipër, KVO konstaton se operatori ekonomik “SINTEZA CO” Sh.p.k nuk ka përmbushur kriterin 1/b të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, kriterin 2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar dhe kriteret 2.3.1, 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6 të kapacitetit teknik, si pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit.

Ne nenin 80, pika 1 (a) të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet: “Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

“a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura”; Në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e

përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“PC STORE” shpk**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 32.900.000 (tridhjetë e dy milion e nëntëqind e mijë) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e Suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.